



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 113/ 2012

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Muhamet Shala kryesues, Xhevdet Abazi dhe Muhamet Rexha anëtarë, duke vendosur përkitazi për ankesat e subjektit politik Lëvizjes Vetëvendosje (LVV), dega Ferizaj, si dhe Organizatës Rrjeti Ballkanik për Gazetari Hulumtuese (BIRN), me seli në Prishtinë, paraqitur kundër, subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), dega Ferizaj, për shkak vendosjes së posterave në veturnë, më afër se 100 metra nga Qendra e Votimit gjatë ditës së votimit, në Zgjedhjet e Jashtëzakonshme për Kryetar të Komunës së Ferizajt, në seancën e panelit të mbajtur me 03.05.2012, mori këtë:

VENDIM

Miratohen si të bazuara ankesat e subjektit politik Lëvizjes Vetëvendosje (LVV), dega në Ferizaj, Organizatës Rrjeti Ballkanik për Gazetari Hulumtuese (BIRN), me seli në Prishtinë: Anr.113/2012 dhe Anr.119/2012, dhe subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), dega në Ferizaj, i shqiptohet dënim i më gjobë në vlerë prej 2200 (dymijë e dyqind) euro, të cilën detyrohet ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) dite nga dita e pranimit të këtij vendimi.

Arsyetim

PZAP, më datë 30.04.2010, ka pranuar ankesën Anr.113/2012, nga subjekti politik LVV, me të cilën pretendohet se me datën 29.04.2012, rreth orës 14:00, në Qendren e Votimit QV “ Konstantin Kristoforidhi ”, në Nerodime në Vendvotimin 2505d, sipas pretenduesit të ankesës një person është ofruar me automjetin e tij në të cilin kishte vendosur postera të kandidatit për kryetar të Komunës së Ferizajt nga subjekti politik PDK, Agim Aliu. Sipas pretenduesit të ankesës vatura në fjalë ishte e tipit Audi 80 me ngjyrë të kuqe me targa 04115 ab. Parashtruesi i ankesës pretendon se ka pasur shkelje të Rregullës Zgjedhore Nr.11/2009, neni 6 paragrafi 1 pika (a) dhe pika (b), si dhe Rregullës Zgjedhore Nr.13/2009, neni 7 paragrafi 1 pika (b).

Parashtruesi i ankesës i ka bashkangjitur ankesës si dëshmi kopjen e printuar të fotos.

PZAP-i, e informoi subjektin politik PDK, në kuptim të nenit 4 paragrafi 3 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, më datë 01.05.2012, për ankesën që është bërë ndaj këtij subjekti politik nga LVV, dhe ka kërkuar që të përgjigjet ndaj ankesës deri më datë 02.05.2012, në ora 14:00.

PZAP-i, me datën 02.05.2012, mori përgjigjen e kërkuar nga subjekti politik PDK lidhur me ankesën Anr.113/2012, të paraqitur nga subjekti politik LVV, ku në përgjigjen në ankesë subjekti politik PDK thekson se lidhur me pretendimet e subjektit politik LVV se është bërë reklamë(fushatë), me posterin e kandidatit për Kryetar të Komunës së Ferizajit, Agim Aliut, të vendosur në veturnë në ditën e zgjedhjeve, sipas përgjigjes së subjektit politik PDK, nuk qëndrojnë për arsyen se personi me veturnë Audi 80 e kuqe me targa 04115 ab, ka qenë duke votuar në atë ditë dhe fotoja e vendosur në veturnë, ka qenë nga ditët e kaluara të fushatës, si dhe sipas përgjigjes në ankesë personi në fjalë ka harruar të largoj posterin nga vatura në ditën e zgjedhjeve.

Po ashtu, PZAP, më datë 30.04.2010, ka pranuar ankesën Anr.119/2012, nga Organizata BIRN me të cilën pretendohet se me datën 29.04.2012 në Qendrën e Votimit 2505/D, në shkollën fillore “ Konstantin Kristoforidhi” në fshatin Nerodime të Ferizajt, gjatë zgjedhjeve të jashtëzakonshme, për Kryetar të Komunës së Ferizajt, që nga ora 12:40 deri në orën 13:40, sipas pretenduesit të ankesës në oborrin e QV 2505/D ngjitur me objektin, ka qenë e parkuar veturnë Audi 80, ngjyrë të kuqe me targat RKS-04-115 AB, në të cilën veturnë sipas parashtruesit të ankesës ka qenë vendosur një poster (pllakat) me figurën dhe emrin e kandidatit për kryetar të Komunës së Ferizajt, nga subjekti politik PDK. Parashtruesi i ankesës pretendon se me këtë veprim është shkelur nisi 36 paragrafi 1 pika a) të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme (LZP).

Parashtruesi i ankesës ka bashkangjitur ankesës një CD.

PZAP-i, e informoi subjektin politik PDK, në kuptim të nenit 4 paragrafi 3 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, më datë 01.05.2012, për ankesën që është bërë ndaj këtij subjekti politik nga Organizata BIRN, dhe ka kërkuar që të përgjigjet ndaj ankesës deri më datë 02.05.2012, në ora 14:00. PZAP-i, me datën 02.05.2012, mori përgjigjen e kërkuar nga subjekti politik PDK lidhur me ankesën Anr.119/2012, të paraqitur nga Organizata BIRN, ku në përgjigjen në ankesë subjekti politik PDK thekson se lidhur me pretendimet e paraqitura nga Organizata BIRN se në Qendrën e Votimit në shkollen fillore “Konstantin Kristoforidhi”, në fshatin Nerodime të Ferizajt, kanë vërejtur se një person me veturnë Audi 80 ngjyrë të kuqe ka vendosur posterin e kandidatit për kryetar të Komunës së Ferizajt, Agim Aliu, nuk qëndron për arsyen se sipas përgjigjes në ankesë thuhet se personi në fjalë, nga pakujdesia ka harruar posterin në veturnë, në ditën e votimit, mirëpo siç theksohet në përgjigje kjo nuk është bërë për qëllime të fushatës, sepse subjekti politik PDK i ka njoftuar anëtaret e tij për mos shkeljen e kodit zgjedhor.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj dhe analizoi shkresat e lëndës gjeti se:

Ankesa janë të bazuara

Nga fotografitë dhe CD të cilat janë ofruar si provë dhe të cilat gjenden në shkresat e lëndës shihet se posterat e kandidatit për kryetar Komune të Ferizajt Agim Aliu nga radhët e subjektit politik PDK, janë të vendosura në afërsi më të vogël se 100 metra në ditën e votimit të datës 29.04.2012., në QV” Konstandin Kristoforidhi”, në Nerodime, në Vendvotimin 2505d në ditën e votimit të datës 29.04.2012. Sipas Nenit 85 paragrafin 1 të LZP-së, *të gjitha subjektet politike të cilat nuk kanë larguar materialet e fushatave të tyre zgjedhore të vendosura brenda dhe rrëth cilit do VV ose QV në rreze prej 100 metra, çfarëdo materiali i tillë i mbetur 24 orë para fillimit të votimit duhet të largohen nga anëtarët e KVV-ve ose menaxheri i QV-së. Subjektet politike të cilat nuk kanë larguar dhe/ose janë gjetur duke postuar material të fushatës zgjedhore pas afatit kohor të vendosur duhet të raportohen në PZAP për shkelje të këtij ligji.*

Për përcaktimin e lartësisë së gjobës të vendosur në dispozitiv të këtij vendimi PZAP-i, ka marrë parasysh faktorët në vijim:

- Natyra e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor;
- Shkallën dhe peshën e shkeljes;
- Nëse subjekti politik ka marrë pjesë në zgjedhjet e mëparshme, konsiderohet se kanë qenë të njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës;
- Nëse subjekti politik ka bërë shkelje të ligjeve zgjedhore në fuqi në këto zgjedhje apo në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë si dhe
- Shumën e fondeve të marra nga subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve të lidhura më fushatën zgjedhore.

Andaj, duke marr parasysh se nga ana e subjektit politik PDK pa dyshim është shkelur dispozita e nenit 85 paragrafin 1 të LZP-së me atë se posteri i kandidatit të saj për kryetar Komune janë vendosur në afërsi më të afërt se 100 metra nga QV 2505d, si dhe faktorët e cituar më lart për përcaktimin e lartësisë së gjobës, në kuptim të nenit Nenit 120 parografi 1 pika (c) të LZP-së, PZAP-i vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoba e përfshire është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa në Prishtinë

Anr. 113/2012 më datën 03.05.2012.

